

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Rruga “Abdi Toptani” Nr. 1;

E-mail: klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al

V E N D I M

Nr. 22, Datë 28/07/2019

PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR
NË AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT, MBI “AUDITIMIN FINANCIAR
DHE PËRPUTHSHMËRISË”.
për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datën 31.12.2018

Nga auditimi i ushtruar në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, Tiranë, me objekt “*Auditimin Financiar dhe Përputhshmërie*”, për periudhën 01.01.2017 deri në 31.12.2018, mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare, shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësisë materiale për të cilën japim *opinion të kualifikuar*. Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtor i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit mbi “*Auditimin Financiar dhe Përputhshmërie*”, të ushtruar në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit Tiranë, sipas programit të auditimit nr.1439/1 prot., datë 04.01.2018 për veprimtarinë nga data 01.01.2017 deri 31.12.2018.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

OPINIONI I AUDITUESIT:

I.Opinion mbi përputhshmërinë (I kualifikuar)

Baza për opinionin mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë (ISSAI 4000¹).

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së AKU-s me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të AKU-së.

Në opinionin tonë, veprimtaria e AKU-s në aspektin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, nuk është në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin ligjor të aplikueshëm dhe përkatës, për të cilat konstatuam sisteme jo plotësisht efektive të kontrollit të brendshëm.

Transaksionet e kryera gjatë ekzekutimit të buxhetit të AKU-së nuk kanë qenë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me bazën ligjore dhe rregullative në fuqi, përfshirë rregullat e prokurimeve dhe ato buxhetore.

Baza për opinionin mbi përputhshmërinë

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 ”Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur materialitetit, nivelit të riskut si dhe mbi gjykimin profesional të audituesit, përfshirë marrjen në konsideratë të risqeve të mospërputhshmërisë materiale të transaksioneve me kriteret e parashikuara.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinionit të kualifikuar**

Nga evidencat e marra rezultoi se, u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, të cilat konsistojnë si më poshtë:

- Nga AKU janë lidhur kontrata për mirëmbajtjen e sistemit AKU -net, për të tre vitet 2015-2016 deri në gusht 2017 ku daton pagesa e fundit për këto shërbime ky sistem ka pasur standart suport të tij dhe suport zhvillimi sipas përshkrimit të shërbimeve të cilat janë në **shumën në total 14,416,6126 lekë.**

-Ky sistem ka shfaqur probleme për gjatë vitit 2016 kohë në të cilën ishte nën suport dhe mirëmbajtje dhe për të cilën paguheshin dhe miratoheshin raporte nga AKU, e njëjta situatë ka vazhduar dhe përgjatë vitit 2017 ku për të cilin janë shpenzuar fonde buxhetore për mirëmbajtjen e tij sipas kontratave të cilësuar më sipër, deri sa në vitin 2018 është i abandonuar dhe rralle herë përdoret për të dhëna historike nga Inspektorët kur është i mundur akses në sistem. Gjithashtu nga ana e grupit të auditimit në prani të punonjësve të AKU-S u tentua të kishim akses në sistem, por rezultoi se ishte totalisht jashtë funksionit.

- Nga auditimi i dokumentacionit të pagesave të kryera nëpërmjet bankës, AKU ka paguar detyrimin e dëmshpërblimit të dëmit jashtëkontraktor në **shumën 329,967,907 lekë** jo në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.

¹ ISSAI 4000 – “ Standard i Auditimit të Përputhshmërisë” Prezantim i pergjithshem i udhezimeve per auditimin e perputhshmerise

-Nga auditimi i prokurimeve publike u konstatuan devijime dhe shmangie nga kuadri ligjor rregullues, në aspektin e procesit të administrimit të dokumentacionit ligjor, si fizik dhe në SPE.

-Nga auditimi i praktikave të inspektimit të kryera në Operatorit të biznesit, u konstatua se, nga titullarët e AKU-s janë firmosur autorizime dhe janë ushtruar inspektimet, procedura të cilat janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV rregulla të përgjithshme të programimit dhe autorizimit të inspektimit nën 24, 25, dhe 26 ku frekuenca e inspektimeve e tejkalon numrin e parashikuar në Ligj, që duhet të kryejnë të gjithë inspektoratet në Republikën e Shqipërisë në një OB sipas parashikimit në nenin 26 pika 2 “Periudha maksimale e lejuar e inspektimit vjetor është nga 5 deri në 15 ditë. 3. Në llogaritjen e periudhës maksimale të lejuar nuk përfshihet kohëzgjatja”. Ndërkohë që evidentohen raste të mos veprimit dhe ushtrimit të kompetencave ligjore, në raste të caktuar si dhe tejkalim kompetencash në raste të tjera të evidentuara.

Opinion i kualifikuar²:

Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 4000, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së, i kryer në subjektin AKU u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësishme materiale për të cilën **japim opinion të kualifikuar².**

II. Opinion mbi auditimin e pasqyrave financiare.

Auditimi u krye në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit financiar të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit mbështetur në standardet ISSAI 1700², dhe ISSAI 1200³ kërkesat e manualit të auditimit financiar të KLSH dhe ligjit nr. 154/2014 ‘Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit’. Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi administruar janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë. Bazuar në procedurat analitike dhe teste të detajeve, pas vlerësimit të kontrollit të brendshëm, për të arritur nivelin e kërkuar të sigurisë së arsyeshme, që na lejon të shprehim një opinion nëse pasqyrat financiare nuk janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar.

Baza për Opinionin

Nga auditimi i pasqyrave financiare, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit Financiar, përse i takon shkallës së zbatimit nga AKU të standardeve të kontabilitetit, të ligjit mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, udhëzimeve e kushteve të vendosura apo termave mbi raportimin financiar, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit financiar*), u evidentua se informacioni financiar i këtij subjekti nuk është paraqitur në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar në të gjitha aspektet materiale, kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Ne kemi audituar pasqyrat financiare, për vitin ushtrimor deri më 31 dhjetor 2017.

ISSAI 1700 , dhe ISSAI 1200-

Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përse i takon gjetjeve nga auditimi.

Audituesi shpreh një opinion të kualifikuar kur arrin në përfundimin se llogaritë nuk janë pa gabime materiale apo transaksionet në fjalë nuk përputhen në të gjitha aspektet materiale me autoritetet; ose (ii) nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit.

Grupi i auditimit ka administruar evidenca të mjaftueshme për të krijuar bindje të arsyeshme për të mundësuar dhënien e një opinioni të pavarur. Si përfundim deklaratat financiare janë paraqitur në përputhje me kërkesat e ligjit të kontabilitetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

-Nga auditimi konstatohet se godinat e ndërtuara nga Komisioni Europian në kuadër të zbatimit të Instrumentit të para zgjerimit (IPA2011), me çmimi total i kontratës është **4,546,967.14 euro** nuk janë të evidentuara si asete të AKU dhe nuk janë të regjistruara në kontabilitet si AQT, Drejtorisë së Përgjithshme të AKU

-Nga auditimi konstatohet se në kontabilitetin e AKU-s nuk është e evidentuar e gjithë vlera e investimit të projektit IPA 2009 "Consolidation of the Food Safety System in Albania" dhe "Establishment of the National Food Authority, Albania", investim i Delegacionit Evropian, komponent i të cilit ka qenë zhvillimi i pjesës së Teknologjise dhe Informacionit përafërsisht në total në vlerën **875.000 Euro** ndarë në, Infrastruktura dhe programe softwar vlera 475.000 Euro dhe Assistance dhe zhvillim sistemi AKU-net vlera 400.000 Euro.

Për sa më lart ne lidhje me sistemin Aku-net përjashtuar listën së detajuar të aseteve e cila është e identifikuar, në vlerën 23,505,364.66 lekë, Sektori i Buxhetit dhe Financës nuk disponon dokumentacion pasi është mbyllur projekti për zhvillimin e sistemit Aku-net për programe softwar në vlerën 475.000 Euro vlerë e cila rezulton e pa regjistruar në kontabilitet.

Opinionit i auditimit:

Sipas opinionit të KLSH-së, mbështetur në standardet e mësipërme, në disa aspekte materiale ka anomali në pasqyrat financiare, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të AKU në datën 31 dhjetor 2017 për të cilën ***japim opinionin të kualifikuar.***

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PERMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.

Gjetja.1. Nga auditimi në lidhje me ekzekutimin e masave administrative gjore me shoqëritë përmbarimore si dhe nga auditimi i dokumentacionit mbi procedurat e përzgjedhjes dhe kontraktimit të shoqërive përmbarimore për ekzekutimin e masave administrative gjore të vendosura nga AKU për subjektet private, konstatohet:

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në zbatim të legjislacionit të fushës vendos masa administrative (gjore), masa të cilat në momentin që përbëjnë titull ekzekutiv në zbatim të Ligjit 10279/2010 "Për kundravajtjet administrative", dhe Kodit të Procedurës Civile ekzekutohen me shërbim përmbarimor.

Prej vitesh (periudha kohore ishte e pamundur për tu evidentuar nga zyra juridike e institucionit) AKU ka ndjekur ekzekutimin kryesisht me përmbarues privat, me arsyetimin "për shkak të neglizhencave dhe vonesave që sjell përmbarimi shtetëror".

Për dy vitet objekt auditimi 2017-2018 është ndjekur e njëjta procedurë për ekzekutimin e masave administrative gjore. Autoritetit Kombëtar të Ushqimit ka dërguar kërkesa për ekzekutim të detyrueshëm në përmbarues shtetëror dhe përmbarues gjyqësor privat.

Nga auditimi konstatohet se për periudhën tetor 2017 deri në momentin e auditimit, AKU operon me 5 përmbarues gjyqësor privat për ekzekutimin e masave administrative gjore.

Referuar informacionit nga zyra juridike e AKU –s shpjegohet se:

Në vijimësi përmbaruesit gjyqësor janë paraqitur pranë AKU dhe kanë shprehur interes për bashkëpunim për ekzekutimin e masave administrative gjore, por nuk u shpjegua fakti se si

këto shoqëri janë në njohje të faktit të titujve ekzekutiv dhe mbi çfarë njoftimi të hapur apo thirrje publike për shprehje interesi ato i janë referuar kërkesës së tyre.

Asnjë rast nuk na u paraqit nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit procesi i përzgjedhjes së kontraktimit të përmbaruesve të ndryshëm gjyqësor dhe dhënia e titujve ekzekutiv për ekzekutim këtyre shoqërive, përveç paraqitjes për shprehje interesi. Nga cila listë e miratuar nga Ministria e Drejtësisë ata janë përzgjedhur, mbi çfarë kriteresh dhe eksperience, dhe pse pikërisht titullari ka përzgjedhur këta përmbarues.

Pavarësisht faktit që Institucionet shtetërore janë të përjashtuara nga tarifat e ekzekutimit me shërbim përmbarimor si shtetëror apo privat, kjo nuk e justifikon mungesën e transparencës në mënyrën e përzgjedhjes së përmbaruesve dhe kontraktimit të tyre.

Gjithashtu konstatohet se përmbaruesi privat T. në momentet kur përmbaruesi privat ushtronte të drejtën e sekuestrove konservative mbi llogaritë e AKU-s, si përfaqësues i shoqërisë M. dhe rrezikonte pezullimin e veprimtarisë, në të njëjtën periudhë ish drejtuesit të lidhin marrëveshje me këtë shoqëri si kreditor për titujt ekzekutiv të AKU, për ekzekutim (rreth 145 tituj), në shkelje të plotë të ligjit 10031 datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat” i ndryshuar, në kushtet e konfliktit të interesit sipas përcaktimeve të nenit 9 të këtij Ligji. *Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

1.1. Rekomandimi: Agjencia e Prokurimit Publik ti propozojë Këshillit të Ministrave, amendime të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, të parashikojë mënyrën dhe procedurat që duhet të ndiqen nga Institucionet publike shtetërore për kontraktimin e shërbimit të përmbaruesve privat, meqenëse ky shërbim nuk është parashikuar si përjashtim në këtë nen të ligjit “Për Prokurimin publik”, si përgatitjen dhe nxjerrjen e aktet nënligjore rregulluese të kësaj fushe.

Menjëherë

1.2. Rekomandimi: MBZHRAU në bazë të parashikimeve të përcaktuara në Ligjin nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar, në pikën 4, të nenit 70 të tij përcakton që “Mënyra e vjeljes së gjobave dhe shpërndarja e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.”. MBZHRAU në bashkëpunim me AKU të hartojnë dhe propozojnë pranë Këshillit të Ministrave akte nënligjore të cilat të rregullojnë mënyrën e përzgjedhjes së përmbaruesve për ekzekutim të masave administrative gjobë, për AKU dhe institucionet e tjera nën varësi të kësaj Ministrie.

Të merren masa të menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE.

1.-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare konstatohet se godinat e ndërtuara nga Komisioni European në kuadër të zbatimit të Instrumentit të para zgjerimit (IPA2011), me çmim total i kontratës në vlerën **4,546,967.14 euro** nuk janë të evidentuara si asete të AKU dhe nuk janë të regjistruara në kontabilitet si AQT, kjo me justifikimin se nuk janë kryer kolaudimet e fundit si dhe certifikatat e pronësisë së objekteve. Lidhur me këto godina të cilat që nga viti 2014 janë në funksion dhe në përdorim nga 9 (nëntë) Drejtoritë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, por të pa evidentuara në asnjë dokumentacion përveç certifikatës së pranimit e firmosur nga ish drejtuesit e AKU-s dhe përfaqësuesve të KE, dhe kompanisë ndërtuese nuk është ndërmarre asnjë veprim për regjistrimin në kontabilitet si dhe procesin e hipotekimit të tyre pasi nuk ekziston asnjë dokumentacion lidhur me to. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr.78-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Nga AKU, Sektori i Financës të merren masat për të kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare vlerën e drejtë të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara, duke regjistruar dhe evidentuar si Aktive të Qëndrueshëm të Trupëzuar (AQT), vlerën prej **4,546,967.14 Euro**. Nga Sektori i Financës të merren masat duke kryer veprimet përkatëse rregulluese kontabël në vijimësi dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare/formatet përkatëse të AKU-së, për vitin 2020.

Menjëherë

1.2. Rekomandimi: Nga AKU në bashkëpunim me MBZHR, të përgatitet dokumentacioni ligjor i pronësisë për objektet në zbatim të vendimit të KM, dhe njësisë të vartësisë dhe të kryhet regjistrimi Pronave të Paluajtshme.

Menjëherë

2.-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të pagesave të kryera nëpërmjet bankës konstatohet se AKU ka në përdorim një sistem AKU -net i cili është përfituar nga fondet e Komisionit European në kuadër të zbatimit të Instrumentit të para zgjerimit (IPA) për krijimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit në fillimet e aktivitetit të tij. Si pjesë e këtij projekti është bërë në vitin 2010-2011 dhurimi i pajisjeve TIK dhe programeve të cilat janë pjesë e aseteve të Drejtorisë së Përgjithshme të AKU. Sipas të dhënave të cilat sektori i IT në AKU ka paraqitur, ndihma e Delegacionit Evropian në pjesën e Teknologjisë së Informacionit përafërsisht ka qene në total **875.000 Euro** ndarë në, Infrastrukturë dhe Programe software vlera 475.000 Euro dhe Assistance dhe zhvillim sistemi AKU-net vlera 400.000 Euro.

Për sa më lart përjashtuar listës së detajuar të aseteve e cila është e identifikuar, në vlerën 23,505,364.66 lekë në lidhje me sistemin Aku-net Sektori i Buxhetit dhe Financës nuk disponon aktet e dhurimit në lidhje me mbylljen e projektit të sistemit Aku-net për *Softin. Sistemi AKU-net në kontabilitetin e AKU-s nuk është i evidentuar me të gjithë vlerën e investimit të projektit IPA 2009 "Consolidation of the Food Safety System in Albania" dhe "Establishment of the National Food Authority, Albania". Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet nr.78-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

2.1. Rekomandimi: Të merren masat për të kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare *Softin AKU-net* duke u evidentuar e gjithë vlera e investimit të projektit IPA 2009 "Consolidation of the Food Safety System in Albania" dhe "Establishment of the National Food Authority, Albania". Nga Sektori i Buxhetit dhe Financës të merren masat duke kryer veprimet përkatëse rregulluese kontabël në vijimësi dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare/formatet përkatëse të AKU-së, për vitin 2020.

Menjëherë

3.-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave dytësore është konstatuar se AKU, nuk ka një dokument kontrolli (Akt-Kontrolli, apo Proces-Verbal), format tip, për inspektimin në rastet e eksporteve dhe tranzitimit të produkteve. I vetmi dokument që lëshohet, në raste kur subjektet paraqiten pranë inspektorëve të AKU, përpara se të kryejnë veprimet doganore të eksportit, është fatura për arkëtim, faturë e cila lëshohet për efekt të pagesës në Bankë, të tarifës. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se formatet e caktuara për regjimin e eksportit dhe tranzitimit janë përgatitur dhe janë paraqitur për miratim në MBZHR, por ende nuk ka një miratim për këtë. Mungesa e këtij dokumenti i jep Doganës një arsye, që të vijojë me procedurat, sepse duket qartësisht se ndalimi, fillimisht tek inspektorët e AKU është thjesht për çështje tarife dhe jo kontrolli.

Gjithashtu konstatohet se nuk ka edhe një miratim , në lidhje me tarifën e certifikatës së eksportit drejt Kosovës dhe Maqedonisë, megjithëse nga AKU, është paraqitur propozimi referuar koston. Modeli i certifikatave për produktet me origjinë jo shtazore, të cilat

eksportohen në Kosovë dhe Maqedoni është miratuar në Korrik 2018. *Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet nr.78-106, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

- Nga auditimi konstatohet se mungesa e një dokument kontrolli (Akt-Kontrolli, apo Proces-Verbal), format tip, për inspektimin në rastet e eksporteve dhe tranzitimit të produkteve ka sjellë si pasojë të ardhura dytësore të munguara për AKU-n, ku konstatohet se në DRAKU/Kukës (PIK Morinë), nga inspektorët e AKU, **në asnjë rast nuk janë kryer procedura eksporti.** Nga të dhënat e kësaj Dogane, për periudhën Janar 2017 deri Gusht 2018 janë kryer rreth **4200 kalime** ose *praktika eksporti, pa miratimin e inspektoreve të AKU.* E njëjta situatë, konstatohet në DRAKU/Shkodër (PIK Hani Hotit) ku nga të dhënat e Doganës, rezulton se janë kryer rreth 4000 kalime (praktika eksporti) pa miratimin e inspektorëve të AKU. Gjithashtu e njëjta situatë, pa miratimin e inspektorëve të AKU, është edhe PIK/Porti Durrës. Përveç aspekteve dhe detyrimeve në fushën e sigurisë ushqimore, mos paraqitja e subjekteve pranë inspektorëve të AKU dhe kryerja e procedurave doganore pa kryer procedura Inspektorët e AKU, pra pa miratimin e tyre, ka sjellë edhe mungesën e të ardhurave, i cili referuar Urdhrit të Ministrit të Bujqësisë me Nr.963 datë 21.02.2011 i cili përcakton llojin e kontrolleve që do të bëhet në PIK, për regjimin e eksportit, si dhe VKM 750 datë 14.07.2010, arrin rreth 8.200.000lek.

Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet nr.78-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

3.1. Rekomandimi: Nga AKU në bashkëpunim me MBZHR të miratohet dokumenti i kontrollit (Akt-Kontrolli ose Proces-Verbal), format tip, për inspektimin në rastet e eksporteve dhe tranzitimit të produkteve. I vetmi dokument që lëshohet, në raste kur subjektet paraqiten pranë inspektorëve të AKU, përpara se të kryejnë veprimet doganore të eksportit, është fatura për arkëtim, faturë e cila lëshohet për efekt të pagesës në Bankë, të tarifës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3.2. Rekomandimi: Nga AKU të intesifikohet bashkëpunimi me MBZHR për miratimin në lidhje me tarifën e certifikatës së eksportit drejt Kosovës dhe Maqedonisë, megjithëse nga AKU, është paraqitur propozimi referuar kostos.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3.3. Rekomandimi: Nga AKU të intesifikohet bashkëpunimi me DPD për ndërprerjen e praktikës së kryerjes se procedurave të eksportit pa praninë e inspektorëve të AKU-s dhe miratimin e inspektorëve të AKU, e cila cënon aspekte dhe detyrimeve në fushën e sigurisë ushqimore. Po kështu, mos paraqitja e subjekteve pranë inspektorëve të AKU dhe kryerja e procedurave doganore pa kryer procedura të miratimit nga Inspektorët e AKU, sjellin edhe mungesën e të ardhurave, për Buxhetin e Shtetit, në referim të Urdhrit të Ministrit të Bujqësisë me Nr.963 datë 21.02.2011 i cili përcakton llojin e kontrolleve që do të bëhet në PIK, për regjimin e eksportit, si dhe VKM 750 datë 14.07.2010.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

4.-Gjetje nga auditimi: Lidhur me mirëmbajtjen e sistemit AKU net, Sektori IT i është drejtuar titullarit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, duke shpjeguar rëndësinë e sistemit të Teknologjisë së Informacionit për institucionin dhe pjesëve përbërëse të tij, ka parashtruar dhe ka kërkuar **support teknik me te avancuar** për mbarëvajtjen sa më të mirë të punës dhe zhvillimin me tej të sistemit AKU-net me kërkesat, problematikat dhe sfidat që ka AKU. **Për sa më sipër nga AKU janë lidhur kontrata për mirëmbajtjen e sistemit për të tre vitet 2015-2016 dhe deri në gusht 2017 ku daton pagesa e fundit për këto shërbime ky system ka**

pasur standart support të tij dhe support zhvillimi sipas përshkrimit të shërbimeve të cilat janë në vlerën në total 14,416,6126 lekë.

Nga ana e grupit të auditit u kërkuar raporte mbi përdorimin nga Inspektorët e AKU-s , raportimi online apo raporte të gjenerua nga ky sistem. Nga sektorët përkatës si dhe nga titullarët e AKU-s konfirmohet se ky sistem nga momenti i ndërprerjes së suportit, pra përfundimit të kontratave përveç rasteve të veçuara për kategori raporti të caktuar ishte jashtë funksioni dhe nuk përdorej nga Inspektorët, as për raportime online dhe as për raportime të tjera, gjithashtu ky sistem nuk ka funksionuar dhe gjatë kohës që mbulohej me shërbimin e mirëmbajtjes.

Ky sistem ka shfaqur probleme për gjatë vitit 2016 kohë në të cilën ishte nën support dhe mirëmbajtje dhe për të cilën paguheshin dhe miratoheshin raporte nga AKU, e njëjta situatë ka vazhduar dhe përgjatë vitit 2017 kohë dhe për të cilin janë shpenzuar fonde buxhetore për mirëmbajtjen e tij sipas kontratave të cilësuar më sipër, deri sa në vitin 2018 është i abandonuar dhe rralle herë përdoret për të dhëna historike nga Inspektorët kur është i mundur akses në sistem. Gjithashtu nga ana e grupit të auditimit në prani të punonjësve të AKU-s u tentua të kishim akses në sistem dhe rezultoi se ishte totalisht jashtë funksionit. *Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet nr.39-78, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

4.1. Rekomandimi: Nga AKU në bashkupim me AKSH-in të merren masa të menjëhershme për rivitalizimin dhe përmirësimin e sistemit AKU-net, me qëllim funksioni dhe përdorimin nga Inspektorët, për raportime online në përputhje me Ligjin për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

Menjëherë

5.-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shpenzimeve të karburantit për vitin 2017, pas verifikimit të fletë udhëtimeve për mjetin me targë, TR0996L me të cilin ka kryer lëvizje kryesisht z.D.S. me detyrë Drejtori i Përgjithshëm i AKU, nisur nga shpeshtësia në kronologji dhe konsumi i karburantit u krye kryqëzim i daljeve së shkresave nga portokolli të firmosura nga drejtori i AKU-së dhe Autorizim Shërbimeve, ku rezultoi se:

-Në 39 raste në këto autorizime nuk evidentohen kërkesa për shërbim, apo dokumentime justifikuese e vërtetuese si (kuponat tatimorë) të lëshuar nga furnizuesi që mund të vërtetonin furnizimin e mjetit përkatës sipas targës e datave të autorizimeve. *Në 14 raste prej tyre është evidentuar se Drejtori i Përgjithshëm rezulton të ketë qenë prezent në institucion dhe jo në lëvizje apo destinacionin siç është përshkruar në autorizimet e shërbimit, kryesisht jashtë Tiranës dhe me largësi mbi 100 km.* Nisur sa më sipër konstatojmë se: z. D.S. ish Drejtor i Përgjithshëm i AKU për periudhën Janar-Tetor 2017, për sasinë 910 litra benzinë, 910 x173.05 lekë/litër= 157,475 lekë duke rënë ndesh me pikën nr. 36 të Udhëzimit nr.30, datë. 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ku përcaktohet se ne lidhje me dokumentimin e lëvizjes së aktiveve duhet që: Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë, si dhe atë të mashtrimeve. *Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr.39-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e AKU të marrë masa për zbatimin, menaxhimin me eficence dhe efektivitet të aktiveve, përdorimin e tyre vetëm për qëllime e nevoja të institucionit, duke shmangur në këtë mënyrë risqet e mundshme gjatë menaxhimit e funksionimit të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme.

6.-Gjetje nga auditimi:Nga auditimi i praktikave të importeve për Produktet e Mbrojtjes së Bimëve-ve (PMB) të importuara konstatohet se në territorin e Republikës së Shqipërisë qarkullojnë PMB të cilat blihen dhe importohen jashtë vendeve të BE, konkretisht nga Kina apo vende të tjera dhe me aplikantë të ndryshëm nga aplikanti i miratuar në regjistrin e PMB të miratuara për import dhe përdorim në vend, nga ana e grupit të auditimit u kërkuar sqarime lidhur me këtë ndryshim që konstatohet, dhe nga specialist i PMB-ve z. I.B. në MBZHR, nëpërmjet sektorit të PIK në AKU na u vunë në dispozicion miratime të cilat kishin të bënin me njoftim nga aplikanti i reregjistruar I cili njoftonte se kishte degë prodhimi dhe në Kinë, duke specifikuar emrin e prodhuesit, vendin dhe adresën e saktë të njohura nga Ministria, por konstatohet se specifikimi i emrave të shoqërive jashtë BE, të regjistruara, certifikuar dhe miratuara nga MBZHR nuk ishte e reflektuar në regjistrin e PMB-ve të lejuara dhe reregjistruara ose të kishte një listë të njohur të këtyre shoqërive nga të cilat lejohet blerja, importi i artikujve PMB ne Republikën e Shqipërisë jashtë BE me vend origjine KINËN apo vende të tjera. Theksojmë se një listë e tillë me ndryshime të aplikantëve nuk është publike për asnjë nga palët e interesit gjithashtu dhe për vetë AKU e cila mjaftohet me një konfirmim nga specialist i PMB-ve në MBZHR për të lejuar praktikën e importit me njoftimin paraprak dhe miratimin e importit të PMB-ve, AKU e merr në rrugë zyrtare me e-mail nga SPMB-ja në MBZHR dhe më pas këtë njoftim AKU e dërgon në Pikën e Inspektimit Kufitar nga ku do të importohet ngarkesa e PMB. Bazuar në legjislacionin e sipërcituar kontrolli i parë i “Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve” kryhet nga inspektorët e AKU-së në Pikat e Inspektimit Kufitar.

- AKU nuk ka kryer marrje mostrash për Kontrollin cilësor të PMB-ve bazuar në Kreun X, “Analizat cilësore të P.M.B. -ve” të VKM nr. 1 188, datë 20.8.2008 “Për miratimin e rregullave për importin, tregtimin, transportin, ruajtjen, përdorimin dhe asgjësimin e Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve” i ndryshuar. Theksojmë se këto analiza cilësore të PMB-ve kryhen nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV). I cili nëpërmjet shkresave me nr. 625 Prot, datë, 05.07.2017 dhe nr. 458/1 datë, 19.06.2018, parashtron se e ka të pamundur kryerjen e analizave cilësore të PMB-ve, për këtë arsye nga AKU për vitin 2018 nuk janë marrë mostra për kontrollin cilësor të PMB.

-Evidentohet se AKU, nuk ka laborator të analizave, të formulimeve, duke e lënë jashtë kontrollit inputin që vjen nga importi, të cilat importohen me certifikatë analize nga vete prodhuesi dhe në shumicën e rasteve janë fotokopje të cilat cenojnë sigurinë e vlefshmërisë së dokumentit dhe përmbajtjes së tij, nga pikëpamja administrative. Pra PMB-t që hyjnë për përdorim në vendin tonë nuk i nënshtrohen asnjë analize laboratorike të formulimit për të parë vetitë e tyre fiziko - kimike; përbërjen e lëndës vepruese dhe përmbajtjen e saj në % apo g/L, përbërjen dhe përmbajtjen e lëndëve mbushëse (inerte) si dhe përbërjen e aditiveve që ju shtohen formulimeve, rrjedhimisht këto PMB nuk kalojnë paraprakisht në testet laboratorike dhe në terren për të parë veprimin e tyre (provat fushore) në kushtet aktuale të vendit tonë.

- Nga auditimi i regjistrin të importeve të PMB vënë në dispozicion nga Sektori I PIK në AKU, rezulton se janë kryer importe të PMB-ve, kryesisht me vend origjine Kinën, pavarësisht se nga vendet Europiane nëpërmjet direktivave të ndryshme ekziston një mbikëqyrje e rrepte ndaj produkteve generike që vijnë nga Kina duke i konsideruar importin e tyre me risk të lartë. Nga ana e MBZHR si dhe AKU nuk ka një regjistër të vlerësimit të riskut të lartë të tyre, dhe një monitorim më të rreptë, por ndodh e kundërta ku importet më të mëdha kryhen pikërisht me vend origjine Kinën.

-Më datë 02.03.2018 është njoftuar PIK Durrës për importin që do të kryhet nga subjekti A., nga i cili do të importohet sasia 2000 kg PMB regjistruar me nr.546 datë 02.05.2014 në regjistrin e PMB të lejuara në territorin e Shqipërisë me emrin Cobrekey me lëndë active

oksiklorur (cu) me klasifikim fungicide regjistruar në Shqipëri nga aplikanti Industrial Q. K. (kompani spanjolle), më datë 11.02.2016 sipas shkresës së miratimit është bërë ndryshimi i kërkesës së aplikantit të mësipërm duke shtuar dhe një linjë të fabrikimit të tyre nga Y.I. CO.ltd Kinë. Nga praktika e dokumenteve të importit midis dokumentacionit që dispononte PIK Durrës dhe dokumentacionit të pikës doganore Durrës u konstatua se ka mospërputhje të të dhënave të deklaruara në dokumentacion lidhur me PMB që importohet. Pavarësisht se rasti është bërë publik dhe nga AKU janë kryer dhe shteruar procedurat e inspektimit, theksojmë se nuk ka pasur verifikim të mëtejshëm midis AKU dhe pikës doganore Durrës për ballafaqimin e dokumentacionit, me qëllim garantimin zinxhirit të sigurisë ushqimore. *Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqet nr.,152-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

6.1. Rekomandimi: Nga MBZHR të publikohet specifikimi i emrave të shoqërive jashtë BE, të regjistruara, certifikuar dhe miratuara nga MBZHR dhe të reflektohet në regjistrin e PMB-ve të lejuara dhe regjistruara, në Republikën e Shqipërisë jashtë BE me vend origjine KINËN apo dhe vende të tjera. Theksojmë se një listë e tillë me ndryshime të aplikantëve duhet të jetë publike për të gjithë palët e interesat gjithashtu dhe për vetë AKU e cila duhet të ketë akses të të dhënave informuese për PMB dhe jo të mjaftohet me një konfirmim nga specialist i PMB-ve në MBZHR për të lejuar praktikën e importit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

6.2.Rekomandimi: Nga MBZHR të vlerësohet ngritja e laboratorit të analizave të formulimeve duke ndërprerë mundësinë e lënies jashtë kontrollit të inputit që vjen nga importi, të cilat importohen me certifikatë analize nga vete prodhuesi dhe në shumicën e rasteve janë fotokopje të cilat çenojnë sigurinë e vlefshmërisë së dokumentit dhe përmbajtjes së tij, nga pikëpamja administrative. Pra PMB-t që hyjnë për përdorim në vendin tonë nuk i nënshtrohen asnjë analize laboratorike të formulimit për të parë vetitë e tyre fiziko - kimike; përbërjen e lëndës vepruese dhe përmbajtjen e saj në % apo g/L, përbërjen dhe përmbajtjen e lendeve mbushëse (inerte) si dhe përbërjen e aditiveve që ju shtohen formulimeve, rrjedhimisht këto PMB nuk kalojnë paraprakisht në testet laboratorike dhe në terren për të parë veprimin e tyre (provat fushore) në kushtet aktuale të vendit tonë.

Menjëherë

6.3. Rekomandimi: -Të kryhen trajnime të vazhdueshme dhe bashkëkohore për inspektorët në PIK lidhur me verifikimin e dokumentacionit të praktikave të importit;
-Të intensifikohet bashkëpunimi me Pikat doganore lidhur me bashkërendimin e dokumentacionit të plotë të importeve të çdo llojë natyre produkti i cili ka lidhje me sigurinë ushqimore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

6.4. Rekomandimi: Në rregulloren e brendshme të AKU, në listën e dokumenteve që kërkohen për praktikën e importit, të shtohet dhe kërkesa lidhur me bill of loading, e cila përshkruan me saktësi llojin e produktit të importit që kryhet. Po kështu në rregulloren të përcaktohet edhe kryerja e verifikimit online, për certifikatat e analizave të cilat janë të lëshuara elektronikisht, pa firmë dhe vulë të njomë nga lëshuesi i tyre duke vlerësuar mundësinë e bashkërendimit me sisteme të integruara me rrjetin evropian të laboratorëve të analizave për verifikimin sa më të shpejtë të certifikatave të analizave, lëshuar nga këto laboratore, lidhur me vërtetësinë e tyre duke rritur sigurinë e zinxhirit ushqimor për qytetarët dhe njëkohësisht duke mos u bërë pengesë artificiale për Operatorët e biznesit.

Menjëherë

7.-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi praktikave të importeve konstatohet se është lejuar importimi i **produkti PMB i llojit Vapcomore 20% SP** nga Subjekti "A." shpk i cili me shkresë nr.500 prot datë 19.1.2018 kërkon zgjidhje lidhur me ngarkesën me PMB të importuar me datë 13.1.2018 e cila i është bllokuar nga Dega Doganore Tiranë, pasi nuk ka

konfirmim të kontrollit fitosanitar nga AKU. Me datë 13.1.2018 ky subjekt ka importuar përmes PIK Kakavijë një ngarkesë me PMB të llojit Vapcomore 20% SP, e cila është bllokuar nga Dega Doganore Tiranë, për shkak se nuk kishte procesverbalin e kontrollit nga inspektorët e AKU në PIK Kakavijë

Autoritetit Kombëtar të Ushqimit e konsideron problematikën e trajtuar mësipërm si problematikë që nuk është në kompetencë të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe e përcjell për trajtim në MBZHR. Për sa më sipër konstatohet se importi i pmb-s nuk është në përputhje me kërkesat e parashikuara për importin e p.m.b-ve në Ligjin nr.105.dt.27.10.2016. “Për mbrojtjen e bimeve” dhe në V.K.M nr.1188.dt.20.08.2008 (i ndryshuar), pika 9 të kreun II të VKM ku përcaktohet: çdo person i pajisur me leje importi, që kërkon të importojë pmb, të klasifikuara si “pmb të rrezikshme” dhe “pmb me rrezik të lartë”, duhet të njoftojë më parë spmb-në, për çdo ngarkesë. njoftimi bëhet sipas një formulari, i cili përmban. a) emrin tregtar dhe numrin e paketimit të pmb-së; b) numrin dhe datën e regjistrimit; c) vendin e origjinës; ç) emtin e prodhuesit; d) sasinë; dh) datën dhe 'vendin nga importohet; e) pikën e kalimit kufitar nga do të futet në territorin e republikës së Shqipërisë, njoftimi bëhet me shkrim jo më vonë se 5 ditë para datës së hyrjes së tyre në Republikën e Shqipërisë.

Ndërkohë që ka qenë evident fakti se produktit në fjalë (PMB të llojit Vapcomore 20 % SP) është një PMB që i ka përfunduar afati i regjistrimit në tetor 2017 dhe kjo PMB është e ndaluar të importohet në territorin e Republikës së Shqipërisë kjo në zbatim të ligjit Nr.105/2016, datë, 27/10/2016 për importi PMB-s të regjistruara, rezulton se ky import është lejuar të hyjë dhe qarkulloj në Shqipëri, ka mjaftuar një komunikim elektronik me MBZHR duke i bërë interpretim i cili nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi i cili rregullon fushën e sigurisë ushqimore dhe konkretisht, Ligji nr.9362 datë 24.03.20105 “Për Shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve” i ndryshuar me ligjin 105/2016 Neni U dhe 18, Ligjit 10416 datë 07.04.2011 “Për Materialin Mbjellës dhe Shumëzues Bimor” i ndryshuar me ligjin 105/2015 Neni 42 pika I dhe 2, Ligjit 10390 datë 03.03.2011 “Për Plehrat e Përdorimit për Bimësinë”, i ndryshuar Neni 13, Ligjit 9863 datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” i ndryshuar, Neni 15, pikat 1,2 Neni 17, pika 1 dhe Neni 51.si dhe VKM 750 dt 14.07.2011 Për Miratimin e Rregullave të Inspektimit Karantinor Fitosanitar” Kreu III, dhe në territorin e Shqipërisë të lejohet importi i PMB-s i cili nuk është i lejuar për tu importuar sipas kërkesave të parashikuara për Importin e P.M.B-ve në ligjin Nr.105.dt.27.10.2016. “Për mbrojtjen e bimëve” dhe në V.K.M nr.1188.dt.20.08.2008 (i ndryshuar), pika 9 të kreun II të VKM ku përcaktohet: Çdo person i pajisur me leje importi, që kërkon të importojë PMB, të klasifikuara si “PMB të rrezikshme” dhe “PMB me rrezik të lartë”. Pavarësisht miratimit nga MBZHR, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, nuk duhet të lejonte importin e mësipërm, i cili është në kundërshtim të plotë me legjislacionin në fuqi. *Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqet nr.,152-198 të Projekt Raportit të Auditimit*

7.1. Rekomandimi: Nga MBZHR dhe AKU të merret në shqyrtim rasti i lejimit të importimit të produkti PMB i llojit Vapcomore 20% SP. Ndërkohë që ka qenë evident fakti se produktit në fjalë (PMB të llojit Vapcomore 20 % SP) është një PMB që i ka përfunduar afati i regjistrimit në tetor 2017 dhe kjo PMB është e ndaluar të importohet në territorin e Republikës së Shqipërisë kjo në zbatim të ligjit Nr.105/2016, datë, 27/10/2016 për importi PMB-s të regjistruara, rezulton se ky import është lejuar të hyjë dhe qarkulloj në Shqipëri, ka mjaftuar një komunikim elektronik me MBZHR duke i bërë interpretim i cili nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe të ndërpriten të tilla praktika, të cilat janë abuzive në kundërshtim të plotë me legjislacionin në fuqi dhe cenojnë sigurinë ushqimore të konsumatorit në Republikën e Shqipërisë.

Menjëherë

8.-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikave të importeve konstatohet se nga Sektori i Inspektimit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së dhe Drejtoritë Rajonale të AKU-së **për Plehun Silicon Mix me emërtimin EC-Fertilizers**, bazuar në raportimin e dërguar nga Drejtoria Rajonale e AKU Tiranë për muajin Shtator 2017 ka rezultuar se në inspektimin e kryer në subjektin “A.K.”, me aktivitet: Tregtim të plehrave të përdorimit për bimësinë”, është evidentuar një pleh i përdorimit për bimësinë me emërtimin “Silicon MIX” me etiketë jo të plotë si dhe me dokumentacion pjesërisht i rregullt.

Nga ana e DRAKU Durrës është kryer inspektimi në subjektin furnizues, Koordinatorja e DRAKU Durrës me e-mailin e datës 23.10.2017 informon DP të AKU-së për inspektimin e kryer dha masat administrative përkatësisht: gjobë në vlerën 60.000 lekë, bllokimin e sasisë 4600 l të plehut Silicon MIX, nga 6000 litra të importuara, si dhe është marrë mostër për analizë zyrtare nga laboratorit në QTTB Fushë-Krujë.

Në procedurat e inspektimit saktësohet se: plehu i përdorimit për bujqësinë “silikon Mix” i pasqyruar në etiketë me emërtimin “EC fertilizier” nuk rezulton në listën tipeve të plehrave “EC fertilizier” të miratuara nga BE, sipas shtojcës nr.1 të VKM 774 dt. 07.11.2012, nuk përmbushen të gjitha kërkesat për etiketimin sipas dispozitave të Ligjit 1039 dt 3.03.2011, si dhe në bazë të Ligjit të inspektimit nr.10433 dt. 16.06.2011 neni 38 pika 1 është marrë mostra për tu analizuar në QTTB- fushë Krujë.

Për sa pasqyruar më sipër, në mënyrë të detajuar të ngjarjes lidhur me bllokimin e sasisë prej 4600 litra silicon MIX sipas procesverbalit të bllokimit të mbajtur nga Inspektorët në 20.10.2017 deri në zhbllokimin e tij me 22 Maj 2018, konstatohet se ka një korrespondencë të gjatë shkresash të institucioneve duke shmangur në mënyrë të drejtpërdrejtë një analizë rutinë e cila edhe nëse nuk mund të bëhet nga asnjë laborator në vend, mund të kërkohej të kryhej në laboratorët e ISUV-it ose dhe jashtë vendit, kur koha prej 8 muaj është e mjaftueshme për të marrë një rezultat.

Së dyti, në kapërcim të çdo kompetence ligjore, Ministria nuk duhet të mjaftohej me një shkresë interpretuese evazive në zgjidhje të problemit “*Referuar legjisllacionit në fuqi për plehrat që përdoren në bimësi rezulton se bllokimi i Silicon MIX nuk është bërë konform legjisllacionit në fuqi për importimin dhe vendosjen në treg të plehrave “EC Fertilizers”, pasi kjo kategori nuk i nënshtrohet regjistrimit, sepse është në qarkullim të lirë*”.

Kjo shkresë e cila është kuptuar si urdhër për Titullarin e AKU, i cili ka nxituar ta zhbllokojë produktin pa ditur realisht se çfarë produkti po zhbllokon i cili po përdoret në bujqësi, dhe a cenohet sigurinë ushqimore .

Ministria nuk ka ushtruar kompetencat e saj në përputhje të plotë me ligjin e organizimit funksionimit dhe kompetencave të saj , me vënien para përgjegjësisë së të dy institucioneve të cilat janë në varësi të Ministrisë, që në zbatim të ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore të kryenin analiza Laboratorike të thelluara për të arritur në një konkluzion mbi elementët përbërës të Silikonit mix, mbi rrezikshmërinë e tij, nëse është e evidente, shkallën e rrezikut si dhe të bëj publike rezultatet laboratorike, duke garantuar dhe mbrojtur të drejtat themelore si të qytetarëve dhe të Operatorit të biznesit të garantuara nga Kushtetuta e Vendit. *Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqet nr.,152-198 të Projekt Raportit të Auditimit*

8.1.Rekomandimi: Nga MBZHR dhe AKU të ndërpriten të tilla praktika, të cilat janë abuzive në kundërshtim të plotë me legjisllacionin në fuqi, në zbatim të ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore të kryejnë analiza laboratorike të thelluara për të arritur në një konkluzion mbi elementët përbërës të produkteve të tilla, mbi rrezikshmërinë e tij, nëse është e evidente, shkallën e rrezikut si dhe të bëj publike rezultatet laboratorike, duke garantuar dhe mbrojtur të drejtat themelore si të qytetarëve dhe të Operatorit të biznesit të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Menjëherë

9.-Gjetje nga auditimi:Nga auditimi i procedurave të prokurimit u konstatuan shkelje dhe parregullsi në mbajtjen e dosjeve të procedurave të prokurimeve të vitit 2017, që lidhen kryesisht me inventarizimin dhe në protokollimin në kohë të tyre, *Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr.106-120 të Projekt Raportit të Auditimit*

9.1.Rekomandimi:Drejtoria Juridike të kryhej inventarizimi dhe arkivimin e dosjeve të prokurimeve publike për vitin 2017 me te gjitha dokumentet duke përfshirë dhe raportin mbi realizimin e kontratës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

10.-Gjetje nga auditimi: Sipas verifikimit të të gjitha dosjeve të auditimit, për vitin 2017 dhe 2018, u konstatua se Format Standard 3 i auditimit i cili përmban “*Njoftimin mbi fillimin e angazhimit të auditimit*” nuk protokollohet nga zyra e protokollit e për pasoje nuk i dërgohet zyrtarisht subjektit të auditimit, por ky njoftim behet vetëm ne mënyre elektronike.

-Janë konstatuar raste, kur observimet nga ana e subjektit të audituar pas marrjes së projekt raportit nuk janë të protokolluara nga insitucioni, apo te kenë një shkresë përcjellëse bashkëlidhur nga subjekti i audituar. Ky konstatim bie ndesh me nenin nr.42 të ligjit nr.9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, si dhe ne kundërshtim me Manualin e Auditit të Brendshëm i miratuar nga Ministri i Financave. *Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqet nr.,127 - 152 të të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

10.1.Rekomandimi: Sektori i Auditit të Brendshëm, të marrë masa për të dërguar në mënyre ligjore ashtu si dhe zyrtare Formatin Standard nr. 3 të auditimit i cili përmban “*Njoftimin mbi fillimin e angazhimit të auditimit*” duke ju referuar Manualit të Auditit të Brendshëm, si dhe te protokolloje dokumenatat e dërguara nga subjeket e audituara për ti reflektuar në raportet e tyre e me pas për tu bërë pjesë e dosjeve të auditimit.

Në vazhdimësi

11.-Gjetje nga auditimi:Nga auditimi u konstatua se, Sektori i Auditit të Brendshëm gjatë 2 (dy) viteve objekt auditimi ka funksionuar vetëm me 2 (dy) punonjës, konkretisht një shef sektori dhe një specialist, dhe jo si kundër kërkohet në pikën nr.3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e Kritereve të Krijimit të Njësive të auditit të Brendshëm në Sektorin Publik” i ndryshuar, i cili përcakton se “Njësia e auditit të brendshëm përbëhet jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë”. Krijimi i plote i sektorit të auditit të brendshëm ndikon në forcimin e komponentëve të Kontrollit të Brendshëm. *Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqet nr.,127 - 152 të të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

11.1.Rekomandimi: Të merren masa në plotësimin e organikës së Sektorit të Auditit të Brendshëm me jo më pak se tre (3) punonjës, përfshirë edhe drejtuesin e njësisë, me qëllim minimizimin e risqeve që cenojnë kryerjen e funksioneve të njësisë së këtij sektori.

Menjëherë

12.-Gjetje nga auditimi:U konstatua se pjesë e grupit të auditimit ne disa raste, ishin edhe specialistë të brendshëm të institucionit. Ky veprim bie në kundërshtim me standardet e auditimit. Misioni i auditimit të brendshëm është të japë siguri të arsyeshme për titullarin e njësisë së sektorit publik, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë e sektorit publik por jo të bashkëpunojnë më institucionin i cili për audituesit është objekt

auditimi. Referuar nenit 11 të ligjit nr. 114/2015 për auditimin e brendshëm në sektorin publik i cili përcaktohet se, gupi i auditimit duhet të përbehet nga auditues të cilët janë të certifikuar si dhe të kenë përvojë 5 vite punë si auditues i brendshëm apo i jashtëm. Gjithashtu referuar Manuali të Auditimit të Brendshëm i miratuar nga Ministri i Financave, përcaktohet se, kur titullari i njësisë publike pretendon përfshirjen e një auditimi në planin vjetor të punës, duke kërkuar ekspertë të jashtëm të fushave të veçanta, drejtuesi i NJAB duhet të planifikojë nevojat për ekspertë të jashtëm dhe fondin përkatës për kontraktimin e këtij shërbimi (prokurim). Të dy këto referenca nuk janë zbatuar konform ligjit të sipërcituar. *Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqet nr.,127 - 152 të të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

12.1.Rekomandimi:Njesia e Auditit të Brendshëm, te mare masa ne rast se pretendon përfshirjen ne planin vjetor të punës, të eksperteve të jashtëm te fushave te veçanta ne lidhje me realizimin e objektivave te auditimit, te planifikojnë nevojat për ekspert të jashtëm si dhe fondin përkatës për kontraktimin e këtij shërbimi ose te plotësoje vendin vakant ne sektorin e auditimit te brendshëm me një specialist i cili te mbuloje fushat përkatëse të kërkuara për të kryer auditimet.

Në vazhdimësi

13.-Gjetje nga auditimi:Faza finale e kryerjes së një angazhimi auditimi është rënia dakort me njësinë e audituar lidhur me raportin dhe plotësimi i planit te veprimit. Nga auditimi u konstatua se në asnjë rast në dosjet e auditimit nuk ndodhej ky plan veprimi i cili formon bazat e punës për ndjekjen e procedurave ne të ardhmen dhe dërgohet jo më vonë se 20 dite pune pas dërgimit të raportit final në kundërshtim me Standardin 2410 “Kriteret për Komunimik” si dhe Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit te miratuar nga Ministri i Financave. Gjithashtu nga auditimi u konstatua se përgatitja e Memorandumit nga grupi auditimit në të shumtën e rasteve i paraqitet titullarit përpara fazës së projekt-raportit ashtu si dhe kjo Memo mbi rezultatet e përfundimit të angazhimit të auditimit nuk i drejtohet zyrtarisht Titullarit të Institucionit. *Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqet nr.,127 - 152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

13.1.Rekomandimi: Sektori i auditit, te marre masa ne marrjen e Planit të Veprimit pas dorëzimit të raportit final të çdo angazhimi auditimi, duke bërë të mundur kështu dokumentimin e reagimit të subjektit të audituar mbi reagimin e menaxhimit ne lidhje me rekomandimet, përgjegjësit për zbatimin e rekomandimeve si dhe afatin e përfundimit të zbatimit të rekomandimeve. Gjithashtu sektori i auditit, te përgatisë Memon mbi rezultatet e përfundimit të angazhimit të auditimit, ne mënyre zyrtare drejtuar Titullarit të institucionit, pas përfundimit të angazhimit te auditimit, apo pas marrjes se planit të veprimit nga subjekti i audituar duke ju referuar Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Në vazhdimësi

14.-Gjetje nga auditimi:Në kundërshtim me pikën a) të nenit nr. 17 te ligjit nr. 114/2015 te Auditit të Brendshëm, i cili bën fjalë se “*Audituesve të brendshëm u ndalohej të përfshihen në kryerjen e funksioneve dhe veprimtarive të tjera të njësisë publike, përveç veprimtarisë audituese....*” me urdhrin nr. 8458 datë 16.11.2018 “Për delegim autoriteti” i miratuar nga Titullari i insitucionit z.A.I. ka urdhëruar delegimin e detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-se, tek Z.A.C. me detyrë përgjegjës i sektorit të auditit të brendshëm në Drejtot-inë e Përgjithshme të AKU-së, ushtrim i autoriteti te deleguar nga datat 19-22 nëntor 2018.

-Gjithashtu po në kundërshtim me nenin e ligjit të sipërpërmendur me shkresën nr. 5462 datë 08.08.2018 ka caktuar përfaqësues në grupin e punës për evidentimin e barrierave, jo tarifore në tregtinë e Serbise, ku pjese e këtij grupi është edhe përgjegjësi i sektorit të auditit të

brendshëm. *Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqet nr.,127 - 152 të të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

14.1.Rekomandimi: Titullari i Institucionit të marrë masa ku në asnjë rast audituesit e brendshëm nuk duhet të përfshihen apo të marrin pjesë për kryerjen e funksioneve dhe veprimtarive të tjera të njësisë publike, përveç veprimtarisë audituese.

Në vazhdimësi

15.-Gjetje nga auditimi: Grupi i auditimit konstatoi se edhe pse është ngritur GMS, për vitin 2017 dhe vitin 2018 nuk ka asnjë procesverbal të mbajtur për takimet e kryera, apo për problematikat e trajtuara duke konkluduar se nuk është kryer asnjë mbledhje e GMS në kundërshtim me pikën 2.2.4 të Udhëzimit nr.16 datë 16.07.2016 “Për Përgjegjësitë dhe Detyrat e Koordinatorit të Menaxhimit Financiar.....”. *Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqet nr.,120 - 127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

15.1.Rekomandimi: Nëpunësi autorizues, gjatë mbledhjeve të GMS të marrë masa mbi mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve, mbi problematikat e trajtuara nga anëtarët e grupit të GMS, më qëllim dokumentimin e tyre.

Menjëherë

16.-Gjetje nga auditimi: Në AKU nuk janë organizuar trajnime për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve për tu njohur dhe shkëmbyer përvojë mbi praktikën më të mira në fusha të ndryshme të cilat lidhen me veprimtarinë e punës së secilës Drejtori, si për shembull trajnimi mbi vlerësimin, kufizimin apo reduktimin e riskut etj duke ju referuar Manuali të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i miratuar me urdhrin nr.108 datë 17.11.2016 nga Ministri i Financave. *Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqet nr.,120 - 127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

16.1.Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masat e duhura për zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve dhe të hartojë kërkesa specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe manualin të dalë në zbatim të tij. Në mënyrë të veçantë për menaxhimin e riskut pasi, menaxherët e njësisë nuk zotërojnë informacion për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollin. Gjithashtu, institucioni të hartojë një procedurë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve dhe analizën e tyre.

Menjëherë

17.-Gjetje nga auditimi: Nuk janë hartuar **gjurmët e auditimit** të detajuara për procedurat kryesore, bazuar në gjurmët standarde të emëtuara nga Ministria e Financave. Këto gjurmë të proceseve dhe përgjegjësi, nuk janë identifikuar me emërtimin “Lista e proceseve të punës”, nuk ka miratim dhe arkivim të kësaj gjurme, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit nr. 110/2015 datë 15.10.2015 “Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit”. *Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqet nr.,120 - 127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

17.1.Rekomandimi: Për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të merren masat për të hartuar gjurmët e auditimit, ku të përfshihen proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve me të rëndësishme.

Menjëherë

18.-Gjetje nga auditimi: Nuk janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe **krijimin e Regjistrit të Risqeve**, monitorimin e

kontrolleve të risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave, pra nuk është hartuar një regjistër i identifikimit dhe kontrollit të risqeve dhe adresimi i personave përgjegjës për çdo risk, i cili duhet të plotësohet, përditësohet në vazhdimësi, si dhe të dërgohet ky regjistër në Kryeministri dhe në Ministrinë e Financave, konform përcaktimeve të kreut III “Identifikimi i risqeve” të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. *Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqet nr.,120 - 127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

18.1.Rekomandimi: Institucioni te marrë masa për te krijuar Regjistrin e Riskut për të bërë të mundur identifikimin dhe kontrollin e risqeve si dhe adresimin e personave përgjegjës për çdo risk. Ky regjistër duhet te përditësohet ne vazhdimësi duke reflektuar kështu çdo ndodhi e cila nga ana e menaxhereve gjykohet si risk ne realizimin e objektivave te përcaktuara.

Menjëherë

19.-Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi janë miratuar Nëpunësi autorizues dhe zbatues por vazhdon të mbetet nje problem *caktimi i nëpunësve zbatues për 4 Drejtori Rajonale, për të cilat, procedurat e konkurimit janë tej zgjatur, duke krijuar shume vështirësi ne punën e përditshme operative të këtyre drejtorive (DARKU Lezhë, Dibër, Elbasan, Durrës). Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqet nr.,120 - 127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

19.1.Rekomandim: AKU të intensifikoje bashkëpunimin me Departamentin e Administratës Publike, për plotësimin e vendeve vakante në tërësi dhe veçanërisht pozicionet e kategorisë Nëpunës zbatues në *DARKU Lezhë, Diber, Elbasan, Durrës*, me qëllim reduktimin vështirësive të punës së përditshme opertive të këtyre drejtorive.

Menjëherë

20.-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi inspektimet dhe procedurat e kryera për inspektimin e Operatorit të biznesit M. përgjatë vitit 2017, i cili është stabiliment prodhimi i produkteve ushqimore (produkte qumështi) u konstatua se, nga titullarët e AKU –s janë firmosur 13 autorizime dhe janë ushtruar inspektimet nga grupet e inspektorëve.

Referuar inspektimeve të mësipërme, ky subjekt pavarësisht bllokimit të veprimtarisë që i është komunikuar nga AKU, rezulton se ka vazhduar veprimtarinë prodhuese duke hedhur produkte të pasigurta në treg. Në asnjë nga procedurat e inspektimit nuk rezulton të jenë asgjësuar produktet e bllokuara dhe të konstatuara me aflatoksinë, nga grupet e inspektimit në përputhje me ligjin 9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” nenin 69 “*Blokimi dhe Asgjësimi i ushqimit dhe ushqimit për kafshë*”, asgjësimi i produkteve ushqimore nuk kryhet nga AKU, por kryhet me proces verbal të rregullt sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit (ne prezence edhe të inspektorëve të AKU). Në muajin gusht në inspektimin e fundit, formalisht AKU, kryen zhbllokimin e një aktiviteti prodhues, kur ai në fakt asnjëherë nuk ka rezultuar i tillë.

Nga kronologjia e veprimeve del se, procedurat e inspektimit janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV rregulla të përgjithshme të programimit dhe autorizimit të inspektimit neni ,24, 25, dhe 26. Shkelja konsiston në frekuencën e inspektimeve të cilat tejkalojnë numrin e parashikuar në Ligj, që duhet të kryejnë të gjithë inspektoriatet në Republikën e Shqipërisë në një OB në përputhje me parashikimin e nenit 26 pika 2 “Periudha maksimale e lejuar e inspektimit vjetor është nga 5 deri në 15 ditë. 3. Në llogaritjen e periudhës maksimale të lejuar nuk përfshihet kohëzgjatja”. Ndërkohë që frekuenca në subjekte të tjera të të njëjtës natyrë është 4 herë në vit si N.F., E., N., E., L..*Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqet nr.,152-198 të të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

20.1.Rekomandimi:Nga AKU të merren në analizë procedurat e kryera të inspektimeve në subjektin e Operatorit të biznesit M.. Të merren masa për ndërprerjen e praktikave të tilla, të cilat janë abuzive dhe në kundërshtim të plotë me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë në vazhdimësi

21.-Gjetje nga auditimi:Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi inspektimin e kryer ne subjektin “A.shpk” më 20.04.2018, nga trupat inspektuese te DRAKU Shkodër ne bashkëpunim me DAPKU, konstatohet se:

Bazuar ne Urdherin e DP Nr. 4123, datë 16.10.2017 u krye inspektimi ne subjektin “A.shpk” më datë **17.10.2017**. Gjate kontrollit u konstatua që OBU ushtronte aktivitetin ne kushte të përshtatshme,në subjekt u konstatuan, të depozituara në një vend të veçantë nga vetë subjekti, me mbishkrimin “Mall jo për shitje”, produkte ushqimore jo konforme (me dëmtime apo defekte gjatë prodhimit, afat përdorimi të kaluar) në sasi të 28824 litër pije freskuese të ndryshme; 4680 copë kroasant; 11070 kg makarona. Në lidhje me këto produkte, subjekti ka bërë kërkesën me Nr. 3580 Prot., datë 25.05.2017, drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër dhe për dijeni DRAKU-së Shkodër, për asgjësimin e këtyre produkteve jo konforme për konsum.

Këto produkte, me Proces Verbal vendim “Bllokimi”, u bllokuan deri në momentin e kryerjes së procedurës së asgjësimit,e cila do të kryhej mbasi të kishte një përgjigje zyrtare të analizave të produktit, e cila në fakt nuk është kryer asnjëherë për shkak të mos kryerjes së analizave të elementëve të cilët nuk kryhen në laboratorët në vend, apo në laboratorë jashtë vendit. Pavarësisht këtij fakti dhe pse është tentuar që këto analiza të kryhen, rezultat zyrtar, nuk ka, nëse këto produkte janë konformë standardeve të miratuara për konsum. Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se subjekti për mallrat e mësipërme pavarësisht se nuk ka një përgjigje zyrtare mbi analizat e kërkuara vazhdon të jenë të bllokuara, nga AKU me argumentin e “dyshimeve të arsyeshme”.Veprime të tilla të pambështetura ligjërisht me analiza laboratorike, e ekspozojnë AKU-n drejt risqeve të mundshme ligjore dhe financiare. Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqet nr.,152-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

21.1.Rekomandimi:Nga AKU të merren në analizë procedurat e kryera për inspektimeve në subjektin e Operatorit të biznesit A.. Të merren masa për ndërprerjen e praktikave të tilla, të cilat janë abuzive dhe në kundërshtim të plotë me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë në vazhdimësi

C. GJETJE ME EFEKTE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN, MENAXHIMIN PA EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE: Gjetje për fonde të trajtuara pa efektivitet dhe ekonomikitet në vlerën 344,384,519 lekë (14,416,612 lekë +329,967,907 lekë).

1.Nga auditimi i dokumentacionit të pagesave të kryera nëpërmjet bankës konstatohet se lidhur me mirëmbajtjen e sistemit AKU net, Sektor IT i është drejtuar titullarëve të Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, duke shpjeguar rëndësinë e sistemit te Teknologjisë se Informacionit për institucionin dhe pjesëve përbërëse të tij, ka parashtruar dhe ka kërkuar **support teknik me te avancuar** për mbarëvajtjen sa më të mirë të punës dhe zhvillimin me tej të sistemit AKU-net me kërkesat dhe problematikën dhe sfidat që ka AKU. **Për sa më sipër nga AKU janë lidhur kontrata për mirëmbajtjen e sistemit për të tre vitet 2015-2016 dhe deri në gusht 2017 ku daton pagesa e fundit për këto shërbime ky system ka pasur standart support të tij dhe support zhvillimi sipas përshkrimit të shërbimeve të cilat janë në vlerën në total 14,416,6126 lekë.**

Nga ana e grupit të auditit u kërkuan raporte mbi përdorimin nga Inspektorët e AKU-s , raportimi online apo raporte të gjenerua nga ky sistem.

Nga sektorët përkatës si dhe nga titullarët e AKU-s konfirmohet se ky sistem nga momenti i ndërprerjes së sportit, pra përfundimit të kontratave përveç rasteve të veçuara për kategori raporti të caktuar ishte jashtë funksioni dhe nuk përdorej nga Inspektorët, as për raportime online dhe as për raportime të tjera, gjithashtu ky sistem nuk ka funksionuar dhe gjatë kohës që mbulohej me shërbimin e mirëmbajtjes.

Ky sistem ka shfaqur probleme për gjatë vitit 2016 kohë në të cilën ishte nën support dhe mirëmbajtje dhe për të cilën paguheshin dhe miratoheshin raporte nga AKU, e njëjta situatë ka vazhduar dhe përgjatë vitit 2017 kohë dhe për të cilin janë shpenzuar fonde buxhetore për mirëmbajtjen e tij sipas kontratave të cilësuar më sipër, deri sa në vitin 2018 është i abandonuar dhe rralle herë përdoret për të dhëna historike nga Inspektorët kur është i mundur aksesimi në sistem gjithashtu nga ana e grupit të auditimit në prani të punonjësve të AKU-s u tentua të kishim akses në sytem dhe rezultoi se ishte totalisht jashtë funksionit. *Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet nr.39-78, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

2. Nga auditimi i dokumentacionit të pagesave të kryera nëpërmjet bankës, AKU bazuar në Autorizim nr.1885/2 date 30.03.2018 të Ministrit të Bujqësisë ka kryer ekzekutimin e pagesës së vendimit nr. 3237 datë 06.07.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë e cila ka vendosur ndryshimi i vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë duke pranuar kërkesën e palës paditëse dhe ngarkuar palën e paditur AKU me detyrimin e dëmshpërblimit të dëmit jashtëkontraktor në **shumën 329,967,907 lekë.**

Ekzekutimi i vendimit;

Nga ana e përmbauesit gjyqësor privat, **shoqërisë “T.” sh.p.k.** është vijuar me veprimet procedurale në funksion të ekzekutimit të detyrimit duke lajmëruar ekzekutim vullnetar më datë 27.07.2017 me shkresë 899.prot dhe kaluar në ekzekutim të detyrueshëm. Ndodhur në të tilla rrethana Dega e Thesarit Tiranë ka vendosur sekuestron konservative ndaj llogarive të AKU, duke bllokuar funksionimin e këtij institucioni. pavarësisht se me shkresë të ish drejtorit D.S. nr.3260/1 prot. datë 04.08.2017 i është drejtuar shoqërisë përmbauese se ne zbatim të pkës 6 të dhe Udhëzimit Nr. 01, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisve të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, në pamundësi pagese debitori i drejtohet Gjykatës së Shkallës së Parë për ndarjen e detyrimit dhe pagesën me këste, gjë e cila rezulton se nuk është pranuar nga përmbauesi i cili ka vijuar veprimet dhe me shkresën nr.1447 datë 23.11.2017, i është drejtuar Degës së Thesarit Tiranë për vendosjen e sekuestros konservative në llogari të palës debitore.

Ndodhur në kushte të bllokimit të aktivitetit të AKU, institucioni ka informuar MBZHR me shkresën me Nr. 1214 prot, datë 14.02.2018 mbi faktin se “Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për vitin 2018, ka llogaritur fondin 5,500,000 lekë për likuidim pjesor të detyrimit gjyqësor likuidim që mund të realizohet me lëshimin e “Autorizimit” nga ana e Ministrisë.”

Në vijim të komunikimit me MBZHR, sërish në vijim të shkresës së AKU me nr. 1214 prot., datë 14.02.2018 në lidhje me kreditorin shoqërinë “M.” sh.p.k , Ministria është informuar: Dega e Thesarit Tiranë me shkresën nr. 723/3 prot., datë 09.03.2018 me titull “*Saktësim dhe rivënie të sekuestros konservative*”, ka njoftuar Drejtorinë e Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit që t’i bllokohen fondet buxhetore në Artikullin 602 në favor të kreditorit shoqërisë “M.” sh.p.k në vlerën 329,967,907.4 lekë. Me bllokimin e llogarisë 602 “Shpenzimeve operative”, i gjithë aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, do të jetë i pezulluar.

Nga korrespondenca shkresore me MBZHR mbi ekzekutimin e detyrimit konstatohet se, me shkresën nr. 819 prot. datë 14.09.2018 “*Kërkesë për vendosjen e masës së sekuestros konservative*”, zyra përbarimore T. ka njoftuar Degën e Thesarit, dhe nga ana e saj Dega e Thesarit ka njoftuar me shkresën nr. 6648/1 datë 17.09.2018 Drejtorinë e Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit që do ti bllokohen fondet buxhetore në Arti. 602 në favor të kreditorit shoqërisë “M.” Sh.p.k në vlerën **324,467,907.4 lekë.**’

Me shkresën 6416/1 Prot, datë 19.9.2018, është informuar MBZHR se ‘*kemi shteruar mundësitë buxhetore duke likuiduar shumën prej 5,500,000 (pesëmilione pesëqind mijë) lekë*’ “ më datë 25.06.2018 me urdhër shpenzimit nr. 89, për rrjedhojë Zyra përbarimore tërhoqi urdhrin e masës së sekuestros, duke mundësuar vijimin normal të aktivitetit të AKU-s.

Me shkresë nr.7430/1 Prot datë 18.10.2018 AKU i drejtohet MBZHR për rialokim fondesh, ku me shkresën nr. 404 datë 26.09.2018 rezulton se është akorduar fondi për pagesë të kreditorit shoqërisë “M.” sh.p.k të vlerës 80,000,000 (tetëdhjete milion) lekë, për rrjedhojë është informuar zyra përbarimore T. në lidhje me dakortësinë për likuidimin pjesor të detyrimit ndaj kreditorit të shoqërisë “M.” sh.p.k.

Me këtë shkresë AKU ka informuar Ministrinë se detyrimi i mbetur pas likuidimit të vlerës 80,000,000 (tetëdhjete milion) lekë është **244,467,907.40 lekë** ndaj kreditorit shoqërisë “M.” sh.p.k.”, kjo shumë mbetet atipike për mundësitë buxhetore të AKU-së.

Citojmë shkresën “*AKU e ka të pamundur paraqitjen e një projekti për mënyrën e likuidimit të pjesës së mbetur të detyrimit, pasi fondet për vitin 2018 dhe në vitet në vazhdim janë të parashikuara për zhvillim normal të aktivitetit të AKU.*”

Më tej, AKU ka marrë shkresën datë 15.10.2018 të kreditorit shoqërisë “M.” sh.p.k drejtuar Zyrës Përbarimore T.(e për dijeni AKU) përmes të cilës autorizon zyrës përbarimore të tërheqë urdhrin e masës së sekuestros me qëllim likuidimin e fondit të përcaktuar **80,000,000 (tetëdhjete milion) lekë** ndaj kreditorit shoqërisë “M.” sh.p.k, por edhe thekson se:

- *Kjo nuk nënkupton pezullimin e procedurës përbarimore dhe për këtë shkak do të kërkojmë nga debitori/njësia shpenzuese Autoriteti Kombëtar i Ushqimit **paraqitjen e një projekti për mënyrën e likuidimit të pjesës së mbetur të detyrimit, i cili duhet të na vihet në dispozicion dhe të na njoftohet si palë kreditore brenda afatit 10 -ditor.***”

Për sa më sipër AKU në shkresë thekson faktet se “informojmë se detyrimi i mbetur pas likuidimit të vlerës 80,000,000 (tetëdhjete milion) lekë është **244,467,907.40 lekë** ndaj kreditorit shoqërisë “M.” sh.p.k.”, kjo shumë mbetet atipike për mundësitë buxhetore të AKU-së” *AKU e ka të pamundur paraqitjen e një projekti për mënyrën e likuidimit të pjesës së mbetur të detyrimit, pasi fondet për vitin 2018 dhe në vitet në vazhdim janë të parashikuara për zhvillim normal të aktivitetit të AKU.*

Si dhe vihet re nga shkresat dhe përmbajtja e tyre, AKU ka ngritur një “Alarm” drejt Ministrisë për pezullim të aktivitetit dhe në dukje rezulton se i ka ushtruar të gjitha hapat për mundësinë e ekzekutimit deri sa Ministria ka dhënë autorizimet përkatëse së bashku me rialokim fondesh për të kryer likuidimin e vendimit. Nëse do ti referohemi kronologjisë konstatohet një nxitim i tejskajshëm procedural për likuidimin sa më të shpejtë të kësaj shume atipike për financat e AKU-s dhe të Ministrisë për gjetjen e këtyre fondeve buxhetore për likuidim, arrijmë në këtë konkluzion pasi në kronologjinë e komunikimit shkresor ekziston mundësia e rënies dakord dhe planifikimit të shlyerjes me këste të kësaj shume e cila ka rënduar financat e shtetit shqiptar. Dhe ka qenë pikërisht AKU e cila deklaroi se “*e ka të pamundur paraqitjen e një projekti për mënyrën e likuidimit të pjesës së mbetur të detyrimit, pasi fondet për vitin 2018 dhe në vitet në vazhdim janë të parashikuara për zhvillim normal të aktivitetit të AKU.*” ,duke mos e ushtruar këtë të drejtë dhe rënë në dakortësi me përbaruesin privat T. për hapësirat e mundshme dhe likuidimin me këste të shumës. Pikërisht në momentet kur përbaruesi privat ushtronte të drejtën e sekuestrove konservative mbi llogaritë e AKU-s, dhe rrezikonte pezullimin e veprimtarisë, në të njëjtën

periudhe ish drejtori A.I. autorizon z. L.K. të lidhi marrëveshje me këtë shoqëri si kreditor për titujt ekzekutiv të AKU, për ekzekutim (rreth 145 tituj), në shkelje të plotë të ligjit 10031 datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat” i ndryshuar, në kushtet e konfliktit të interesit sipas përcaktimeve të nenit 9 të këtij Ligji. *Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet nr 39-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

2.1. Rekomandimi: Nga MBZHR dhe AKU të marrin në shqyrtim dhe të analizojnë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për rritjen e kostove buxhetore në dëm të buxhetit të shtetit lidhur me pagesën e dëmshpërblimit të dëmit jashtëkontraktor në **shumën 329’967’907 lekë** dhe të analizohet çdo veprim i kryer prej institucioneve të përfshira në këtë proces.

2.2.Rekomandimi: Nga MBZHR dhe AKU të merren masa të menjëhershme në bashkëpunim dhe me Avokaturën e Shtetit për ndjekjen e procesit në Gjykatë të Lartë paraqitjen e të gjithë dokumentacionit ligjor i cili ndihmon në mbrojtjen e plotë të interesave të Shtetit Shqiptar.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, nenin 59 “Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” dhe pikës 11, Kreu II, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore dhe si dhe VKM nr. 171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil” i ndryshuar, në varësi të analizës së përgjegjëseve, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore :

a. “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58 germa “b” deri “c”.

1. Për **Znj. A. D.** me detyrë dhe në cilësinë e përgjegjëses së zyrës Juridike;
- b. “Vërejtje” për personat që gjenden me përgjegjësi në këtë Raport Përfundimtar Auditimi:
 - 1.A. H.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
 - 2.V. K.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
 - 3.Xh.K.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
 - 4.S.R.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
 - 5.Sh.H.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
 - 6.T.Sh.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
 - 7.V.C.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
 - 8.F.Z.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
 - 9.H.S.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
 - 10.D.D.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
 11. N.H.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
 - 12.A.B.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
 - 13.A.K.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.

- 14.L.Z.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
- 15.R.J.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
- 16.G.H.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
- 17.Z.C.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
- 18.E.C.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
- 19.E.V.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
- 20.V.S.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
- 21.Y.A.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
- 22.I.F.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
- 23.Sh.K.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
- 24.E.M.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
- 25.F.K.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
- 26.P.K.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
- 27.Y.A.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
- 28.A.Q.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
- 29.V.LI., me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
- 30.L.K.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
- 31.M.A.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
- 32.L.Gj.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.
33. T.D.; me detyrë dhe në cilësinë e inspektorit të AKU-s.

E. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion për dhënie e zbatimin e tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte në **“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58 germa “b” deri “c”**, përkatësisht:

1. Për **Z. A.B.**, me detyrë dhe në cilësinë e ish Drejtor i AKU
2. Për **Z. I.Sh.**, me detyrë dhe në cilësinë e ish Drejtor i AKU;
3. Për **Z.D.S.**, me detyrë dhe në cilësinë e ish Drejtor i AKU;
4. Për **Z. K.T.**, me detyrë dhe në cilësinë e ish drejtorit të menaxhimit dhe Riskut; .
5. Për **L.K.**, me detyrë dhe në cilësinë e ish drejtorit të Shërbimeve të Brendshme ;
6. Për **F.S.**, me detyrë dhe në cilësinë e ish drejtorit të DRAKU Tiranë dhe Përgjegjës i sektorit të PIK.
7. Për **M.M.**, me detyrë dhe në cilësinë e ish drejtorit të DRAKU Tiranë;
8. Për **G.Dh.**, me detyrë dhe në cilësinë e ish Juristit të AKU-s;
9. Për **N. C.**, me detyrë dhe në cilësinë e ish Juristit të AKU-s;
10. Për **A.M.**, me detyrë dhe në cilësinë e ish Juristit të AKU-s;
11. Për **E.S.**, me detyrë dhe në cilësinë e ish specialist i IT të AKU-s;

F. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, AKU, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

G. INDICIE PENALE APO VLERËSIM NGA ORGANI I PROKURORISË

Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Vendimi nr.22, datë 28.07.2019 i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, përcillen pranë Departamentit Juridik të KLSH-së, për të vlerësuar dhe gjykuar nëse ekziston ose jo elementët e figurës penale apo indice penale, për sa më poshtë vijon:

Nga auditimi i dokumentacionit të pagesave të kryera nëpërmjet bankes, AKU bazuar në Autorizim nr.1885/2 date 30.03.2018 të Ministrit të Bujqësisë ka kryer ekzekutimin e pagesës së vendimit nr. 3237 datë 06.07.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë e cila ka vendosur ndryshimi i vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë duke pranuar kërkesën e palës paditëse dhe ngarkuar palën e paditur AKU me detyrimin e dëmshpërblimit të dëmit jashtëkontraktor në **shumën 329,967,907 lekë.**

Në lidhje me procesin gjyqësor nga i cili ka rrjedhur detyrimi jashtëkontraktor paguar nga fondet e buxhetit të shtetit, me palë paditëse "M." sh.p.k. dhe palë e paditur Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), në mënyrë të përmbledhur bazuar në informacionin dhe dokumentet e paraqitura nga sektori juridik dhe ai i financës në AKU konstatohet se:

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, në vlerësim të situatës së paraqitur nga autoriteti i ushqimit në Republikën e Kosovës (AUV), i cili njoftonte se në qumështin e tregtuar nga dy operatorë prodhues "M." sh.p.k. dhe "P." sh.p.k. në territorin e vet, kish konstatuar përmbajtje të Aflatoksinës disa herë mbi normën e lejuar te këto produkte, të cilat prodhoheshin dhe tregtoheshin dhe në territorin e Shqipërisë, nëpërmjet shkresës nr. 451 prot. datë 25.02.2013 u është drejtuar operatorëve "M." sh.p.k. dhe "P." sh.p.k

Në vijim për gjurmimin e produktit të qumështit të dyshuar për prani të aflatoksinës, me shkresë nr. 451/1 prot. datë 26.02.2013 "Kërkesë për tërheqje produkti nga tregu" të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit operatorëve "M." sh.p.k. dhe "P." sh.p.k. u është kërkuar tërheqjen urgjentisht nga tregu llojet e produktit qumësht sipas përqindjes së yndyrës dhe llojit të paketimit.

Për sa kërkuar më sipër në shkresat e sipërcituara nuk rezulton me dokumentacion që nga dy Operatorët e Biznesit Ushqimor (OBU) të cilëve u janë drejtuar letrat, nuk ka pasur kundërshtime në lidhje me zbatimin e pjesshëm ose të plotë të ndonjë prej kërkesave ose refuzimin e plotë të tyre.

Për sa më lart, referuar numrit të regjistrimit në Gjykatë nr. 31025-08044-80 Akti datë 11.12.2015,OBU P. (më pas M.), i është drejtuar Gjykatës Administrative të Rrethit Tiranë, kërkesën e saj për dëmshpërblim financiar për dëm të pësuar nga kërkesa e AKU për tërheqje vullnetare të produktit nga tregu dhe nga deklarata publike e Drejtorit të Përgjithshëm të atëhershëm të AKU, e ka bazuar pikërisht mbi këto dy Procesverbale.

-Me vendimin Nr. 1566, dt. 01.04.2016, te Gjykatës Administrative te Shkalles se Pare Tirane , është vendosur rrezimi i kërkesë-padisë si të pa bazuar në ligj dhe në prova. Këtë vendim pala paditëse e ka ankimuar.

Ky vendim është protokolluar pranë AKU me **nr. 1510 Prot, datë 22.4.2016, dhe** ku rezulton i autorizuar për të ndjekur procesin gjyqësor z. G.Dh. është larguar nga shërbimi civil me urdhër 1711/1 prot. date 09.05.2016.

Lidhur me ndjekjen e procesit gjyqësor në Shkallë të Parë , në Sektorin Juridik nuk ka një dosje të vitit 2016 (njoftim kërkesë-padie, prapësime, pretendime lidhur me provat e paraqitura nga pala paditëse etj.) që lidhet me këtë proces gjyqësor, dhe vendimi nr. 1566, datë 01.04.2016 është gjetur rastësisht në një dosje fletë-thirrjesh në tavolinën e punës , në zyrën e Sektorit Juridik. Gjithashtu në këtë vendim identifikohet se pala e paditur nuk është paraqitur në gjykim, por kjo çështje është përfaqësuar dhe mbrojtur vetëm nga përfaqësuesi i Avokaturës së Shtetit.

Referuar fakteve të mësipërme evidentohet se pavarsisht vendimit që ka rrezuar padinë e “M.-t”, konstatohet se duke qene në dijeni të faktit që ky vendim është ankimuar nga pala paditëse në neglizhencë totale dhe në mos veprim nga ana e Institucionit nuk është marrë asnjë masë për mbledhjen e dokumentacionit , analizimin e fakteve, bashkëpunim më intensiv me Avokaturën e shtetit, verifikimin e dëmit të mundshëm material të pretenduar, duke verifikuar/krahasuar Lotet e deklaruara të skaduara, dhe ato që përfshiheshin në shkresën për të cilën pretendohet nga pala paditëse se mund të kish sjellë pasoja materiale ndaj subjektit, duke e lënë mbrojtjen e çështjes në “mëshirë të fatit” dhe të një punonjësi i cili ka qenë në papërgjegjshmërie të plotë të vepr imeve,që kryente.

Nga kjo periudhë dhe më pas nuk ka asnjë veprim nga titullarët apo zyra juridike e AKU lidhur me ndjekjen e çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit, për veç faktit të njohjes me **vendimin e formës së prerë nr. 3237 datë 06.07.2017** të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë e cila ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë duke pranuar kërkesën e palës paditëse dhe ngarkuar palën e paditur AKU, me detyrimin e dëm shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor në shumën 329’967’907 lekë.

Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me nr. 3237 vendimi, datë 6.7.2017, nga trupa gjykuese është marrë në dhomë këshillimi, bazuar në nenin 49, 50 të Ligjit Nr. 49/2012 ,i ndryshuar, pa praninë e përfaqësuesve si të Avokaturës së Shtetit dhe të AKU-pavarsisht natyrës së çështjes, njohjes së një dëmi në vlerë të tillë, krejtësisht atipik. Sa më sipër, AKU nuk rezulton të jetë prezent në zhvillimin e procesit gjyqësor në Apel dhe nuk ka qenë pjesëmarrëse në këtë gjykim. **Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur për çështjen në dhomë këshillimi, edhe pse nisur nga natyra e çështjes, si dhe vendimmarrja mbi njohjen e një dëmi në vlerë të tillë, krejtësisht atipik, mund të vlerësohej prej saj se duhej shqyrtuar në seancë gjyqësore, sipas nenit 51 të Ligjit nr. 49/2012 i ndryshuar.**

Lidhur me zhvillimin e procesit gjyqësor në dhomë këshillimi, AKU e ka ankimuar në Gjykatë të Lartë, duke e konsideruar si shkelje të procesit të rregullt ligjor.

Me njohjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nga ana e AKU, brenda afatit ligjor, të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile, ndaj këtij vendimi është ushtruar e drejta e rekursit në Gjykatën e Lartë me shkresën nr. 3077/1 prot. datë 01.08.2017 e cila pritet të dalë për gjykim pranë kësaj gjykate sipas afateve të njohura nga Kodi Procedurës Civile;

Ekzekutimi i vendimit;

Nga ana e përmbauesit gjyqësor privat, **shoqërisë “T.” sh.p.k.** është vijuar me veprimet procedurale në funksion të ekzekutimit të detyrimit duke lajmëruar ekzekutim vullnetar më datë 27.07 2017 me shkresë 899.prot dhe kaluar në ekzekutim të detyrueshëm. Ndodhur në të tilla rrethana Dega e Thesarit Tiranë ka vendosur sekuestron konservative ndaj llogarive të

AKU, duke bllokuar funksionimin e këtij institucioni pavarësisht se me shkresë të ish drejtorit D.S. nr.3260/1 prot. datë 04.08.2017 i është drejtuar shoqërisë përmbaruese se ne zbatim të pkës 6 të dhe Udhëzimit Nr. 01, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njërive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, në pamundësi pagese debitori i drejtohet Gjykatës së shkallës së parë përndarjen e detyrimit dhe pagesën me këste.

Gjë e cila rezulton se nuk është pranuar nga përmbaruesi i cili ka vijuar veprimet me shkresën nr.1447 datë 23.11.2017 i është drejtuar Degës së Thesarit Tiranë për vendosjen e sekuestros konservative në llogari të palës debitore.

Ndodhur në kushte të bllokimit të aktivitetit të AKU, institucioni ka informuar MBZHR me shkresën me Nr. 1214 prot, datë 14.02.2018 mbi faktin se “Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për vitin 2018, ka llogaritur fondin 5,500,000 lekë për likuidim pjesor të detyrimit gjyqësor likuidim që mund të realizohet me lëshimin e “Autorizimit” nga ana e Ministrisë.”

Në vijim të komunikimit me MBZHR, sërish në vijim të shkresës së AKU me nr. 1214 prot., datë 14.02.2018 në lidhje me kreditorin shoqërinë “M.” sh.p.k , Ministria është informuar:Dega e Thesarit Tiranë me shkresën nr. 723/3 prot., datë 09.03.2018 me titull “Saktësim dhe rivënie të sekuestros konservative”, ka njoftuar se Drejtorisë së Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit i bllokohen fondet buxhetore në Artikullin 602 në favor të kreditorit shoqërisë “M.” sh.p.k në vlerën 329,967,907.4 lekë. Me bllokimin e llogarisë 602 “Shpenzimeve operative”, i gjithë aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, do të jetë i pezulluar.

Nga korrespondenca shkresore me MBZHR mbi ekzekutimin e detyrimit konstatohet se ,me shkresën nr. 819 prot. datë 14.09.2018 “Kërkesë për vendosjen e masës së sekuestros konservative”, zyra përmbarimore T.M.A ka njoftuar Degën e Thesarit, dhe nga ana e saj Dega e Thesarit ka njoftuar me shkresën nr. 6648/1 datë 17.09.2018 Drejtorinë e Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit që do ti bllokohen fondet buxhetore në Arti. 602 në favor të kreditorit shoqërisë “M.” Sh.p.k në vlerën **324,467,907.4 lekë.**

Me shkresën 6416/1 Prot,datë 19.9.2018 , është informuar MBZHR se *kemi shteruar mundësitë buxhetore duke likuiduar shumën prej 5,500,000 (pesëmilionepesëqindmijë)lekë* “ më datë 25.06.2018 me urdhër shpenzimit nr. 89, për rrjedhojë Zyra përmbarimore tërhoqi urdhrin e masës së sekuestros, duke mundësuar vijimin normal të aktivitetet të AKU-s.

Me shkresë nr.7430/1 Prot datë 18.10.2018 AKU i drejtohet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për rialokim fondesh, ku me shkresën nr. 404 datë 26.09.2018 rezulton se është akorduar fondi për pagesë të kreditorit shoqërisë “Milky” sh.p.k të vlerës 80,000,000 (tetëdhjete milion) lekë, për rrjedhojë është informuar zyrën përmbarimore T. në lidhje me dakortësinë për likuidimin pjesor të detyrimit ndaj kreditorit shoqërisë “M.” sh.p.k.

Me këtë shkresë AKU ka informuar Ministrinë se detyrimi i mbetur pas likuidimit të vlerës 80,000,000 (tetëdhjete milion) lekë është **244,467,907.40 lekë** ndaj kreditorit shoqërisë “M.” sh.p.k.”, kjo shumë mbetet atipike për mundësitë buxhetore të AKU-së.

Citojmë shkresën “AKU e ka të pamundur paraqitjen e nje projekti për mënyrën e likuidimit të pjesës së mbetur të detyrimit, pasi fondet për vitin 2018 dhe në vitet në vazhdim janë të parashikuara për zhvillim normal të aktivitetit të AKU.

Më tej, AKU ka marrë shkresën datë 15.10.2018 të kreditorit shoqërisë “M.” sh.p.k drejtuar Zyrës Përmbarimore T. (e për dijeni AKU) përmes të cilës autorizon zyrës përmbarimore të tërheqë urdhëron e masës së sekuestros me qëllim likuidimin e fondit të përcaktuar **80,000,000 (tetëdhjete milion) lekë** ndaj kreditorit shoqërisë “M.” sh.p.k, por edhe thekson se:

- *Kjo nuk nënkupton pezullimin e procedurës përmbarimore dhe për këtë shkak do të kërkojmë nga debitori/njësia shpenzuese Autoriteti Kombëtar i Ushqimit **paraqitjen e një***

projekti për mënyrën e likuidimit të pjesës së mbetur të detyrimit, i cili duhet të na vihet në dispozicion dhe të na njoftohet si palë kreditore brenda afatit 10 -ditor.”

Për sa më sipër AKU në shkresë thekson faktet se informojnë se detyrimi i mbetur pas likuidimit të vlerës 80,000,000 (tetëdhjetë milion) lekë është **244,467,907.40 lekë** ndaj kreditorit shoqërisë “M.” sh.p.k.”, kjo shumë mbetet atipike për mundësitë buxhetore të AKU-së” **AKU e ka të pamundur paraqitjen e një projekti për mënyrën e likuidimit të pjesës së mbetur të detyrimit, pasi fondet për vitin 2018 dhe në vitet në vazhdim janë të parashikuara për zhvillim normal të aktivitetit të AKU.**

Si dhe vihet re nga shkresat dhe përmbajtja e tyre , AKU ka ngritur një “ALERT” drejt Ministrisë për pezullim të aktivitetit dhe në dukje rezulton se i ka ushtruar të gjitha hapat për mundësinë e ekzekutimit deri sa Ministria ka dhënë autorizimet përkatëse se bashku me rialokim fondesh për të kryer likuidimin e vendimit. Nëse do ti referohemi kronologjisë konstatohet një nxitim i tejskajshëm procedural për likuidimin sa më të shpejtë të kësaj shume atipike për financat e AKU-s dhe të Ministrisë për gjetjen e këtyre fondeve buxhetore për likuidim, arrijmë në këtë konkluzion pasi në kronologjinë e komunikimit shkresor ekziston mundësia e rënies dakort dhe planifikimit të shlyerjes me këste të kësaj shume e cila ka rënduar financat e shtetit shqiptar. Dhe ka qenë pikërisht AKU e cila deklaroi se **“e ka të pamundur paraqitjen e një projekti për mënyrën e likuidimit të pjesës së mbetur të detyrimit, pasi fondet për vitin 2018 dhe në vitet në vazhdim janë të parashikuara për zhvillim normal të aktivitetit të AKU.”** duke mos e ushtruar këtë të drejtë dhe rënë në dakortësi me përmbartuesin privat T. për hapsirat e mundshme dhe likuidimin me këste të shumës. Pikërisht në momentet kur përmbartuesi privat ushtronte të drejtën e sekuestrove konservative mi llogaritë e AKU-s, dhe rrezikonte pezullimin e veprimtarisë, në të njëjtin periudhë ish drejtori A.I. autorizon z. L.K. të lidhi marrëveshje me këtë shoqëri si kreditor për titujt ekzekutiv të AKU, për ekzekutim(rreth 145 tituj), në shkelje të plotë të ligjit 10031 datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat” i ndryshuar, në kushtet e konfliktit të interesit sipas përcaktimeve të nenit 9 të këtij Ligji.

-Nga auditimi në lidhje me ekzekutimin e masave administrative gjore me shoqëritë përmbartimore si dhe nga auditimi i dokumentacionit mbi procedurat e përzgjedhjes dhe kontraktimit të shoqërive përmbartimore për ekzekutimin e masave administrative gjore të vendosura nga AKU subjekteve private, konstatohet:

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në zbatim të legjislacionit të fushës vendos masa administrative (gjore), masa të cilat në momentin që përbëjnë titull ekzekutiv në zbatim të Ligjit 10279/2010 “Per kundravajtjet administrative”, dhe Kodit të Procedurës Civile ekzekutohen me shërbim përmbartimor.

Prej vitesh (periudha kohore ishte e pamundur për tu evidentuar nga zyra juridike e institucionit)AKU ka ndjekur ekzekutimin kryesisht me përmbartues privat, me arsyetimin “për shkak të neglizhencave dhe vonesave që sjell përmbartimi shtetëror”.

Për dy vitet objekt auditimi 2017-2018 është ndjekur e njëjta procedurë për ekzekutimin e masave administrative gjore. Autoritetit Kombëtar të Ushqimit ka dërguar kërkesa për ekzekutim të detyrueshëm në përmbartues shtetëror dhe përmbartues gjyqësor privat.

Nga auditimi konstatohet se për periudhën tetor 2017 deri aktualisht AKU, operon me 5 përmbartues gjyqësor privat për ekzekutimin e masave administrative gjore.

Referuar informacionit nga zyra juridike e AKU –s na u shpjegua se :Në vijimësi nga ana e përmbartuesve gjyqësore janë paraqitur pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit shprehje interesi për bashkëpunim për ekzekutimin e masave administrative gjore, por nuk u shpjegua fakti se si këto shoqëri janë në njohje të faktit të titujve ekzekutiv dhe mbi çfarë njoftimi të hapur apo thirrje publike për shprehje interesi ato i janë referuar kërkesës së tyre.

Asnjë rast nuk na u paraqit nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit procesi i përzgjedhjes së kontraktimit të përmbaruesve të ndryshëm gjyqësor dhe dhënia e tituj ekzekutiv për ekzekutim këtyre shoqërive, përveç paraqitjes për shprehje interesi . Nga cila listë e miratuar nga Ministria e Drejtësisë ata janë përzgjedhur, mbi çfarë kriteresh dhe eksperience, dhe pse pikërisht titullari ka përzgjedhur këta përmbarues.

Pavarësisht faktit që Institucionet shtetërore janë të përjashtuara nga tarifat e ekzekutimit me shërbim përmbarimor si shtetëror, apo privat, kjo nuk e justifikon mungesën e transparencës në mënyrën e përzgjedhjes së përmbaruesve dhe kontraktimit të tyre.

Gjithashtu konstatohet se përmbaruesi privat T. në momentet kur përmbaruesi privat ushtronte të drejtën e sekuestrove konservative mi llogaritë e AKU-s, si përfaqësues i shoqërisë M. dhe rrezikonte pezullimin e veprimtarisë, në të njëjtën periudhe ish drejtori A.I. autorizon z.L.K. të lidhi marrëveshje me këtë shoqëri si kreditor për titujt ekzekutiv të AKU, për ekzekutim (rreth 145 tituj), në shkelje të plotë të ligjit 10031 datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat” i ndryshuar, në kushtet e konfliktit të interesit sipas përcaktimeve të nenit 9 të këtij Ligji.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R

Konceptoi: E.Kabashi
Miratoi: B.Arizaj